

Vlerësimi në Mësimdhënie

Ilda KADRIMI

Universitetit European për Turizmin, Tiranë

Dorina KADRIMI

Universiteti “ Aleksander Moisiu” Durrës

Abstrakt

Vlerësimi është gjykimi për cilësinë. Vlerësimi është një mënyrë sistematike e shikimit të çështjeve të rëndësishme. Vlerësimi është sigurimi i informacionit për vendimmarrje. Në arsim vlerësimi shpesh lidhet me testimin dhe ngushtohet duke u kufizuar në arritjet e nxënësit. Vlerësimi është një mjet konstruktiv për përmirësim dhe risi.

Vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike, analizimit dhe interpretimit të informative me qëllim të determinizmit se në çfarë shkalle nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëzues.

Vlerësimi përmban përshkrimin sasior dhe cilësor, gjykon vlerat dhe meritat, bazohet në matjen objektive, të saktë , të vlefshme, të besueshme.

Pra, cilat janë parimet e vlerësimit? Si të vlerësojmë në mjedisin e të nxënit aktiv? Cilat janë hapat për thjeshtëzimin e vlerësimit gjatë të nxënit aktiv? Cili është dallimi në mes të nocioneve “ matje “ dhe “ vlerësim ”? Ajo që është më e rëndësishme, pse duhet të vlerësojmë ? Standardet e vlerësimit. Funksionet e vlerësimit. Procesi i vlerësimit. Llojet e vlerësimit në shkollë. Dokumentet bazë të vlerësimit.

Fjalët kyçe: *vlerësimi, mësuesi, nxënësi, kriteret, rubrikat, procesi i të nxënit*

Hyrje

Vlerësim, siç e shpreh edhe emri, do të thotë t'i japësh një vlerë diçkaje. Mësuesit bëjmë vlerësim kur gjykojmë për diçka apo pjesë të saj, në bazë të disa kriterëve. Sigurisht që, kur komunikojmë me të tjerët, ne të gjithë duhet të biem në një mendje për kriteret që përdorim; si dhe për mënyrën se si përputhet informacioni me kriteret apo si përshkruhet ai prej tyre. Kriteret janë të drejtpërdrejta dhe, madje, të klasifikueshme nga ana sasiore. Aftësia kyçe për vlerësim është përdorimi me efikasitet i kriterëve. Kriteret janë kategori ose parime racionale, që përdoren për të gjykuar vlerën apo logjikën e një ideje. Grupi i kriterëve që përdor një mësues për të bërë vlerësime, janë kategori racionale "me emërues të përbashkët" që duhet të kuptohen dhe me të cilat duhet të pajtohen edhe të tjerët, në një mjedis bashkëpunues. Mësuesi ka tri hapa bazë për vlerësimin. I quajmë këto pyetje: ÇKS:

Cila është çështja apo ideja që vlerësohet?

Cilat janë kriteret që do të përdorim për të vendosur vlerën e idesë apo çështjes dhe aspekteve të saj?

Si do i plotësojnë apo mbështesin faktet, dhe provat këto kriteret?

Mësuesit duhet të japin modele të shumta të përdorimit dhe diskutimit të kriterëve të vlerësimit në klasë. Një nga kriteret më interesante për vlerësimin është etika. Vendimet dhe praktiket etike janë ato që ne i përcaktojmë si të drejta ose të gabuara, në varësi nga ai që bën përcaktimin. Etika përbëhet nga die që lidhen me të drejtën e mësuesit për të qenë të lirë, të respektuar dhe për ta thënë fjalën e mësuesit; nga rritja dhe potenciali i mësuesit nga ana e mësuesit; nga nevojat e mësuesit për të mbijetuar. Vlerësimi ka disa funksione:

Mësuesit i përdorin për t'u vënë nota nxënësve

Mësuesit kujdestarë e përdorin për t'u dhënë këshilla nxënësve.

Roli më i rëndësishëm i vlerësimit është përdorimi i tij në vetë procesin mësimor. Ai i jep mësuesit informacionin për të cilin ka nevojë, në mënyrë që të gjykojë se ç'kanë mësuar nxënësit dhe se ç'duhet bërë më tej. Ai është një mjet i rëndësishëm i motivimit të nxënësve sepse u jep nxënësve informacionin e nevojshëm me qëllim që ata të orientohen dhe përfitojnë nga sukseset dhe dështimet. Vlerësimi është një element thelbësor kur bëhet diagnostifikimi sepse ndihmon mësuesit që të kuptojnë nxënësit, zotësit dhe nevojat e tyre. Vlerësimi është një gjykim që bazohet në matjet e mësuesit. Vlerësimi është gjykim për cilësinë. Në vendim tonë përdoret sistemi numerik me 10 shkallë si sistem formal vlerësimi. Në këtë sistem, shkalla ose nota 10 paraqet vlerën më të lartë të përvetsimit, ndërsa shkalla ose nota 1, vlerëm më të ulët. Mësuesi duhet të bëj kujdes që kjo matje:

- të ketë vlerë,

- të jetë e besueshme,
- të jetë objektive
- t'i shërbejë për punën mësimore.

Ky proces shoqërohet me njëfërë gabimi; sa më mirë të projektohet dhe kryhet një vlerësim, aq i vogël është ky gabim. Një nga pyetjet e para që bëjnë mësuesit kur fillojnë të bëjnë mësim është: "Po për vlerësimin, si t'ia bëjmë?" vlerësimi nuk është çështje e lehtë. Mësuesit vlerësojnë proceset e të nxënësve. Që do të thotë, se ata vëzhgojnë me shumë kujdes për të parë nëse nxënësit mund t'i kryejnë apo jo veprimtaritë e të nxënësve që u janë mësuar dhe të gjejnë mënyra të përmirësojnë të nxënësve. Ata vlerësojnë cilësinë e të menduarit të nxënësve. Rubrika bën që mësuesi të vlerësojë shprehin dhe aftësinë specifike të një veprimtarie të caktuar të të nxënësve.

- * Vlerësimi është gjykimi për cilësinë.
- * Vlerësimi është një mënyrë sistematike e shikimit të çështjeve të rëndësishme.
- * Vlerësimi është sigurimi i informacionit për vendimmarrje.
- * Në arsim vlerësimi shpesh lidhet me testimin dhe ngushtohet duke u kufizuar në arritjet e nxënësve.
- * Vlerësimi është një mjet konstruktiv për përmirësim dhe risi.

Pra, vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike, analizimit dhe interpretimit të informacionit me qëllim të determinizimit se në çfarë shkalle nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëzues. Vlerësimi përmban përshkrimin sasior dhe cilësor, gjykon vlerat dhe meritat, bazohet në matjen objektive, të saktë, të vlefshme, të besueshme.

Parimet

1. Vlerësimi para së gjithash ka për qëllim të nxënësve dhe të arriturat e nxënësve.

- Përmes vlerësimit nxënësit marrin informacion për atë që do të duhet ta mësojnë. Sa do të mësojnë dhe si do të mësojnë, kjo në masë të madhe varet nga vlerësimi që zbatohet.
- Vlerësimi shërben që ta nxisë nxënësin të mësojë dhe t'i japë udhëzime se si të mësojë në mënyrë që t'i përmirësojë të arriturat në mësim dhe jashtë tij. Vlerësimi nuk shërben vetëm që ta vërtetojë se sa ka arritur nxënësi të mësojë.

2. Vlerësimi siguron informacione të plota për të arriturat e nxënësve.

- Vlerësimi siguron edhe informacione për atë që nxënësit e dinë dhe çka mund të bëjnë me atë që dinë.
- Me vlerësim vlerësohen dituritë dhe aftësitë e nxënësve, si dhe vlerat, qëndrimet dhe shprehjet e tyre, që ndikojnë edhe në suksesin në shkollë dhe në të arriturat jashtë shkollës.

- Me vlerësim merren informacione edhe për anët e forta dhe ato të dobëta të nxënësve, që pastaj përdoren për të siguruar përparimin e nxënësve në të arritura.

3. Vlerësimi është pjesë përbërëse e procesit mësimor (të mësimnxënies dhe mësimdhënies).

- Ekziston lidhje e qartë ndërmjet qëllimeve dhe përmbajtjeve të të nxënësve dhe vlerësimit (ndërmjet asaj që mësohet e që ofrohet si mësim dhe asaj që vlerësohet).

- Mësimdhënia, mësimnxënja dhe vlerësimi janë procese të ndërthurura dhe sigurojnë koherencë në mësim.

- Nga qëllimet dhe përmbajtjet mësimore varet çka do të vlerësohet. Nga rezultati i vlerësimit varet si do të zhvillohet mësimi dhe drejt cilave qëllime synon të ecën ai.

- Nxënësi ka rol aktiv në procesin e vlerësimit.

4. Vlerësimi bazohet në përdorimin e më shumë metodave të ndryshme.

- Përdorimi i më shumë metodave të ndryshme mundëson që të zvogëlohen dobësitë dhe kufizimet e secilës metode veçmas.

Vlerësimi në Mjediset e të Nxënësve Aktiv

Si mësuesit që përdorin metodat e të nxënësve aktiv, ato hasin vështirësi kur na kërkohet të vlerësojnë punimet e nxënësve. Cilat janë disa prej vështirësive dhe si i kanë zgjidhur disa mësues?

1. Me kaq shumë veprimtari gjatë mësimin, si ta dijë mësuesi se çfarë të vlerësojë?

Mësuesit bëjnë një listë të aftësive të veçanta që duhen vlerësuar. Listat përdoren si rubrika vlerësimi për të vlerësuar përvetsimimn e këtyre aftësive nga këta nxënës. Këtu mund të përfshihen:

- Llojet e pyetjeve që bëjnë nxënësit
- Provat qe paraqet nxënësi në përgjigjet që jep
- Sfidimi i përgjigjeve të nxënësve me njëri-tjetrin

2. Si mund ta vlerësoj secilin nxënës, kur ata punojnë në grupe?

Mësuesi zgjedhin një nxënës për ta vëzhguar për një periudhë kohe, dhe pastaj kalojnë në një nxënës tjetër. Gjatë kohës së vëzhgimit mësuesi vlerëson kontributin e tij në grup. Rubrikat përdoren për secilin nxënës më vete.

3. Duke qenë se në grup punojnë shumë nxënës, si mund të mbajë mend mësuesi se cilët nxënës kontribojnë?

Mund të bëhet një skemë e uljes së nxënësve në grup. Mësuesi e shënon kur një i caktuar thotë diçka në grup. kjo përdoret për të shënuar kontributet e secilit antar në grup.

4. *Të nxënësit aktiv na ndihmon t'u mësojmë nxënësve si të ndërveprojnë dhe si të mendojnë në mënyrë kritike, por si mund të vlerësojnë mësuesit përvetsimin e përmbajtjes së mësimin?*

Ky vlerësim i tregon mësuesit se nxënësi di si ti zbotojë njohuritë apo jo, dhe shkon përtej te një testi të thjeshtë riprodhues.

Punimet me shkrim i nxënësve janë të dobishme dhe produktive i ndihmojnë ato për të bërë një prezantim, ilustrim, lloje të tjera të afishimit që përdoren si ndimëse të një prezantimi ose diskutimi. Produktet vlerësohen për nga përmbajtja e mësimin si dhe provat e të menduarit kritik. Rubrikat përqëndrohen tek punimet me shkrim.

Vlerësimi pas veprimtarisë:

Për vlerësimin e përmbajtjes mësuesi mund të përgatisë një provim pas debati, që do të ketë lidhje me përmbajtje. Provimi duhet të ketë pyetje të nivelit të lartë, që vlerësojnë si përvetsimin e përmbajtjes, ashtu dhe aftësin për ta zbatuar atë.

Mësuesit duhet t'i kërkojnë nxënësve të bëjnë shkrime të lira për mendimet që kanë për një veprimtari të caktuar.

Për vlerësimin pas veprimtarisë, mësuesi mund të shoh rubrikat si një mënyrë për të vlerësuar njohuritë dhe shprehjet e nxënësit. Këto rubrika kanë për qëllim të vlerësojnë reflektimet me shkrim të nxënësve, si dhe mativimin dhe pjesëmarrjen e tyre.

Pas veprimtarive mësimore, mësuesi mund t'u kërkojë nxënësve të shkruajnë një përmbledhje të shkurtër të pikave kryesore në mësim dhe se si lidhen ato me njëra-tjetrën.

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga nxënësit

Nxënësit mund t'i përdorin rubrikat dhe listat për të vlerësuar perceptimet e tyre për punën që kanë bërë në situatat e të nxënësit aktiv. Kur mësuesit krahasojnë perceptimet e nxënësve me ato të mësuesve, dallimet midis tyre mund të diskutohen dhe mund të sqarohen.

Nxënësit që punojnë në grupe mund të vlerësojnë ecurinë e njëri-tjetrit në grup. Nxënësit duhet të sqarojnë rëndësinë e diskutimit dhe të mendimit të dobishëm e ndihmues.

Hapat për Thjeshtëzimin e Vlerësimit Gjatë të Nxënësit Aktiv

1. Përpara mësimin, mësuesi krijon rubrika të mbështetura në synimet dhe objektivat e mësimin. Vlerësimi është i besueshëm dhe më i vlefshëm kur mësuesit i shprehin qartë synimet dhe objektivat e mësimin, në mënyra që mund t'i kuptojnë nxënësit, prindërit, drejtuesit e shkollës, si dhe në mënyra që mbështesin vëzhgimet gjatë mësimin.
2. Për të hartuar rubrikat për vlerësimin e punës së nxënësve, në fillim mësuesi pvendos për kriteret që përshkruajnë një punë të mirë. Kriteret nuk mund të thonë që nxënësi

thjesht të jap një "përgjigje të saktë" për pyetjen. Po të parashtrij atë lloj arsytimi dhe komunikimi që duhet të bëj nxënësi. Kur zhvillojnë rubrikat dhe listat e vlerësimit, zakonisht mësuesit duhet t'ua shpjegojnë ato edhe nxënësve. Për disa strategji të të nxënësve aktiv, në hartimin e listave dhe të rubrikave të vlerësimit mund të marrin pjesë edhe nxënësit. Kjo ofron një mundësi për t'i mësuar nxënësit. Kur mësuesi shpjegon dhe diskuton rubrikat me nxënësit, edhe t'i përforcojë këto koncepte, nëse është nevoja.

3. Në qoftë se duhen vlerësuar nxënës të caktuar, në krye të listës së vlerësimit vihet emri i nxënësit, data e vëzhgimit, si dhe tema e mësimit. Në qoftë se për nxënës të caktuar përdoren rubrikat vlerësimit, atëherë në to duhet lënë vend për emrin, datën dhe temën e mësimit.
4. Për çdo mësime që përdor strategjitë e të nxënësve aktiv, zgjidheni grupin ose individin që do të vlerësohet që më përpara. Kjo bën të mundur që mësuesi të planifikojë se cilin person dhe cilat aftësi do të vlerësojë në një ditë të caktuar.

Dallimi Mes Nocioneve “ Matje “ Dhe “ Vlerësim ”

Këto dy nocione nuk janë të njëjta. Përdorimi i pasaktë i tyre mund të qojë në përfundime të pasakta. Matja dhe vlerësimi janë pjesë përbërëse dhe jetësore të veprimtarisë së shkollave bashkëkohore. Kur matim diçka në arsim, atëherë përshkruajmë atë duke e vënë përballë diçkaje të krahasueshme. Ndërsa kur ne vlerësojmë diçka, atëherë ne gjykojmë në vlerat e saj. Pra, vlerësimi nënkupton vendosjen e një vlere gjykimi, sasiore dhe cilësore, bazuar në matje. Kjo do të thotë se vlerësimi si koncept është më i gjerë se sa matja dhe në vete përfshin edhe matjen.

Pse Vlerësojmë ?

- * që të dimë se në çfarë stadi, niveli , pozicioni të njohurive jemi,
- * që të dimë se ku dëshirojmë të arrijmë,
- * që të nxjerrim se cilat janë dobësitë, pengesat, të metat që në të ardhmen t'i evitojmë në punën tonë,
- * për të bërë bilancin e njohurive dhe aftësive të arritura gjatë gjysëmvetorit –vitit shkollor,
- * për ta ndihmuar nxënësin të përparojë në formimin e tij,
- * për të siguruar një përdorim të drejtë të vlerësimit të nxënësve,
- * për të kontribuar në ngritjen e cilësisë së mësimit me bazë shkolle.

Standardet e Vlerësimit

Sipas Daniel Stffebeam, drejtues i Komitetit të Përbashkët për Standardet e Vlerësimit në Arsim, përcaktohen rreth 30 standarde të ndara në katër grupe të mëdha :

- * standarde të dobisë – vlerësimi i shërben nevojave praktike
- * standarde të mundësisë – vlerësimi realist dhe i matur
- * standarde të korrektësisë – karakteri i ligjshëm dhe teknik
- * standarde të saktësisë – shfaq dhe pasuron informacion teknikisht të mjaftueshëm.

Standardet e vlerësimit shkurt janë: dobia, mundësia, korrektësia, saktësia. Renditja mund të jetë edhe ndryshe. Dhe, së fundi duhet të kuptojmë se: “Vlerësimi nuk ka përfundim.

Vlerësimi është ciklik. Vlerësimi është reflektim rreth rezultateve. Vlerësimi shërben për t’i përdorur rezultatet për të përmirësuar të nxënëit e nxënësve.”

VII. Funkcionet e Vlerësimit

Mësimi dallon varësisht nga nevojat e nxënësve. Vlerësimi i mundëson nxënësit të përparojë, ndërsa mësuesit të përshtatë më mirë mësimdhënien. Funkzioni kryesor i vlerësimit është të ndihmojë për të kuptuar sa më mirë natyrën dhe cilësinë e çështjes që vlerësohet. Në veçanti funksionet e vlerësimit janë:

- * funksioni formues – shërben për monitorim, planifikim, përmirësim, zhvillim, etj;
- * funksioni përmbledhës – shërben për njohje të përgjegjësisë, për bilancin e njohurive dhe aftësive të arritura gjatë vitit shkollor, për llogaridhënie, për përzgjedhje, për certifikim, akreditim;
- * funksioni proaktiv – i shërben procesit të vendimmarrjes;
- * funksioni retroaktiv - i shërben procesit të llogaridhënies;
- * funksioni psikologjik e social - shërben për të motivuar sjellje të dëshiruara, për të zhvilluar marrëdhënie dhe mbështetje publike;
- * funksioni administrative – shërben për të ushtruar autoritetin. Puna dhe aktiviteti i nxënësve vlerësohet duke u mbështetur në planin dhe programin mësimor, një vlerësim i vetëm mund të përdoret për më tepër se një funksion, sikurse edhe funksione të ndryshme mund të shfrytëzohen e përdoren me më tepër se sa një mënyrë ose metodë vlerësimi.

VIII. Procesi i Vlerësimit

Kontrolli dhe vlerësimi shkojnë bashkë, paralelisht. Përgjithësisht nuk ndodh që të bësh kontrole e të mos vlerësosh, ashtu siç ndodh rrallë që të vlerësosh pa bërë kontroll. Në përgjithësi kontrolli ka të bëjë me konstatimin e një gjendje të caktuar, me sigurimin e

treguesve të saj, ndërsa vlerësimi ka të bëjë me konkludimin rreth saj, me gjykimin rreth treguesit. Në literaturë rekomandohen gjashtë faza të procesit të vlerësimit:

1. *Kuptimi i problemit të vlerësimit* - përcaktimi i objektit të vlerësimit, përcaktimi i audiencave ose të interesuarve, përcaktimi i funksioneve të vlerësimit, përcaktimi i kriterëve që do të përdoren për vlerësimin .
2. *Planifikimi i vlerësimit* - zbërthimi i çështjes që vlerësohet, caktimi i detyrave të vlerësuesve, përzgjedhja e instrumenteve matës dhe për vrojtim, përcaktimi i kampionit, përzgjedhja e procedurave të analizës së të dhënave, caktimi i një orari veprimesh.
3. *Mbledhja e informacionit* - përcaktimi i llojit të informacionit që do të mblidhet, caktimi i burimit të informacionit, caktimi i procedurave dhe i mjeteve për mbledhjen e informacionit, caktimi i personave që do të mbledhin informacionin, caktimi i afatit të mbledhjes së informacionit.
4. *Analiza e të dhënave* - caktimi i procedurës së analizës së të dhënave, caktimi i mënyrës së interpretimit të të dhënave
5. *Raportimi i rezultateve të vlerësimit* - caktimi i audiencës, caktimi i formave të raportimit, caktimi i kohës së raportimit.
6. *Dhënia e rekomandimeve* - caktimi i përmbajtjes për përmirësim, caktimi i afateve për përmirësim.

IX. Llojet e Vlerësimit në Shkollë

Në praktikën shkollore aplikohen lloje të ndryshme të vlerësimit.

Llojet e vlerësimit më të përdorshme që aplikohen në shkollë janë si më poshtë:

1. *Vlerësimi diagnostifikues* – përmes këtij vlerësimi identifikohen vështërsitë e të nxënësve ose problemet që kanë të bëjnë me të nxënësve. Po ashtu përmes vlerësimit diagnostifikues identifikohen anët e dobëta dhe të forta të mësimdhënies , përcaktohen shkaqet e ndryshme të problemeve në mësimnxënie etj ,në mënyrë që të merren masat për përmirësimin dhe avancimin e saj dhe për formulimin e planit për veprim në ndihmë nxënësve.
2. *Vlerësimi formues* – përmes këtij vlerësimi synojmë të identifikojmë gabimet, të metat dhe vështërsitë në punën me nxënës, me qëllim që t’u japim ndihmë. Vlerësimi formues mbikëqyrë ecurinë, procesin, përparimin e nxënësve, mësimdhënësve, siguron informatë kthyesë për të sjellë përmirësime. Kontrollon përparimin e nxënësve së nxënësve gjatë procesit mësimor, pra kontrollon shkallën e zotërimit të objektivave udhëzues.

3. *Vlerësimi përmbledhës* - përcakton arritjet në përfundim të vitit mësimor, në përfundim të programit mësimor. Shërben për të marrë vendime për nxënësit, mësimdhënësit, programet etj. Ka për qëllim notimin dhe certifikimin e nxënësve, gjithashtu siguron informata për të gjykuar përvetësimin e objektivave të lëndës dhe efektshmërisë së programit mësimor.
4. *Vlerësimi i kontestit* – ka për qëllim të përcaktojë kontekstin e shkollës, të klasës, të përshkruajë kushtet dhe rrethanat e punës së shkollës, të identifikojë dhe të vlerësojë nevojat dhe mundësitë në kontekstin e dhënë, ndikimin e tyre në arritjet e nxënësve dhe të shkollës.
5. *Vlerësimi i brendshëm* – kryhet nga brenda shkollës, mund të kryhet nga një apo nga disa mësimdhënës, nga drejtues të shkollës. Vlerësimi i brendshëm është më i përshtatshëm për përmbushjen e qëllimeve të vlerësimit formues. Për vlerësimin e brendshëm më gjerësisht do të flasim përmes temës –vlerësimi në klasë.
6. *Vlerësimi jashtëm* – quhet vlerësim i jashtëm sepse kryhet nga institucionet të veçanta të ngarkuara për vlerësimin në shkollë, për vlerësimin e jashtëm në fund të shkollës së shkollimit, siç është testi i arritshmërisë, provimet e maturës. Vlerësimin e jashtëm mund ta kryejë MASHT, ZRA, DKA, apo vlerësues të pavarur. Vlerësimi i jashtëm zakonisht përdoret për të përmbushur qëllimet e vlerësimit përmbledhës – sumativ.
7. *Vetëvlerësimi* – është proces gjatë të cilit institucioni, shkolla, mësimdhënësi, nxënësi mbledhin informacion për vetën e tyre dhe bëjnë gjykimin e vlerave të tyre. Këtë vlerësim nxënësi e realizon duke krahasuar rezultatet e veta me rezultatet e nxënësve të tjerë, apo duke zgjedhur teknika të ndryshme të vlerësimit. Nëpërmjet vetëvlerësimit nxënësit kanë mundësi që në lidhje me qëllimet e caktuara të mësimin të vlerësojnë veten, arritshmërinë e tyre. Vetëvlerësimi i bazuar në kritere të drejta, krijon bazë për të motivuar, përmirësuar dhe çmuar më tej arritjet në të nxënit e nxënësve.

X. Dokumentet Bazë të Vlerësimit

Fillimisht reflektojnë pjesëmarrësit. Sistemi i vlerësimit duhet të mbështetet në “Udhëzim administrativ për vlerësimin e shkollës së arritshmërisë së nxënësve” i lëshuar nga MASHT, në “Plani dhe programi mësimor” për lëndë dhe klasë përkatëse. Sistemi i vlerësimit duhet të mbështetet mbi një sasi të mjaftueshme të dhënash:

- * vlerësimi me notë për përgjigje;
- * vlerësimi i aktivizimit në vend;
- * vlerësimi i aktivizimit të punës në grupe;
- * vlerësimi me teste afatshkurtra;
- * vlerësimi në fund të nënkategorisë programore;

- * vlerësimi në fund të kategorisë programore;
- * vlerësimi në një periudhë kohore;
- * vlerësimi në gjysmëvjetor;
- * vlerësimi në fund të vitit mësimor, etj;

Bibliografia

Garro, S. “Mësimdhënie bashkëkohore”, Botimet TOENA, Tiranë 2008

Karaj, Th. “Menaxhimi i klasës” (Psikologji e zbatuar në mwsimdhënie), Shtëpia Botuese EMAL, Tiranë 2008.

Temple, Ch., Crawford, A., Saul, W., Samuel. Mathews, R., Makinster, J. "Strategji të mësimdhënies dhe të të nxënies për klasat mendimtare", Përktheu: M. Nishku, B. Musai, CDE, 2006.

J. Zwiers "Zhvillimi i shprehive të të menduarit në klasa 6-12", Përktheu: M. Nishku, B. Musai CDE, 2005.

<http://www.masht->

[gov.net/advCms/documents/Standardet_e_vleresimit_drafti_final_28Korrik.pdf](http://www.masht.gov.net/advCms/documents/Standardet_e_vleresimit_drafti_final_28Korrik.pdf)